



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 2 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i njohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e 54-të, të mbajtur më 01.11.2021, morri vendimin vijues:

VENDIM

Denoncimi i regjistruar sipas numrit 12-187/1 të 13.01.2020. Refuzohet.

KSHPK-ja konstatoi se në përputhje me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, organ tjetër është kompetent për të vepruar në lidhje me pretendimet në denoncimin e parashtruesit. Denoncimi me dokumentet shoqëruese duhet të dorëzohet në Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut për veprime kompetente.

Lënda me numër 12-187/1 të datës 13.01.2020 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i KSHPK-së, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

Arsyetim

Më 13.01.2020, një kërkesë u dërgua nga një parashtrues i njohur dhe është formuar lënda me numër 12-187/1 të 13.01.2021.

Në kërkesën e dorëzuar, parashtruesi shpreh pakënaqësi me veprimet e ///, gjyqtarit të Gjykatës Themelore /// për lëndën ///. Parashtruesi thekson se gjyqtari i cekur në denoncim nuk e ka thirrur qëllimisht në seancë, as atë si i pandehur dhe as dëshmitarët, për motive materiale, me qëllim për t'i liruar të pandehurit e tjerë të rastit. Ai thekson se gjyqtari i lartpërmendur besonte në dëshminë e një dëshmitari vetëm sepse ai dëshmitar ishte person zyrtar i punësuar në MPB të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Kërkon nga KSHPK që të marrë masa dhe të rishyrtojë rastin, në drejtim të verifikimit dhe konfirmimit të pretendimeve të saj në denoncim dhe mbi këtë bazë të vendosë sanksione për të gjitha palët e përfshira. Në shtojcë të denoncimit, u dorëzuan edhe prova.

Pas shqyrtimit të pretendimeve në denoncim dhe provave të dorëzuara, KSHPK-ja konstaton se organi tjetër është kompetent për të vepruar sipas pretendimeve në denoncimin e parashtruesit. KSHPK-ja denoncimin dhe provat do t'ia dorëzojë Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë për

veprime kompetente. Duke pasur parasysh tē theksuarēn mē sipēr, KSHPK vendosi si nē dispozitēn e kētij vendimi.

Dorēzuar deri te:

- Arkivi i KSHPK -sē
- Parashtruesi

KOMISIONI SHTETЌOROR
PЉR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
KRYETAR,
Biljana Ivanovska

Pērgaditi: Mr D. D.
Miratoi: K. H.

